

# Ndryshimi i kartëmonedhave dhe monedhave vazhdon



S V E R I G E S R I K S B A N K

# Kartëmonedhat dhe monedhat e Suedisë



# Ndryshimi i kartëmonedhave dhe monedhave vazhdon

Në vitin 2015, Riksbank filloi të fuste në qarkullim kartëmonedhat e reja prej 20, 50, 200 dhe 1000 krona. Në tetor do të futen në qarkullim kartëmonedhat e reja prej 100 dhe 500 krona. Ne po ashtu do të kemi edhe monedha të reja prej 1, 2 dhe 5 krona. Kartëmonedhat e reja do të kenë karakteristika të reja sigurie që ofrojnë mbrojtje më të mirë ndaj falsifikimit dhe monedhat do të jenë më të vogla, më të lehta e pa nikel.

Për një periudhë kohe do të qarkullojnë në treg si kartëmonedhat e monedhat e vjetra ashtu dhe të rejat. Kartëmonedhat dhe monedhat e tanishme do të bëhen të pavlefshme gradualisht (përveç monedhës 10 krona e cila nuk do të zëvendësohet). Në mënyrë që të mos rrezikoni t'ju mbeten kartëmonedha dhe monedha të pavlefshme në shtëpi, paguani me to ose depozitoni në llogarinë tuaj bankare sa më parë.

Ju lutemi kini parasysh se mund të jetë e vështirë për dyqanet dhe bankat të pranojnë sasi të mëdha monedhash, veçanërisht kur ne arrijmë në fazën përfundimtare të ndryshimit. Mos i lini gjërat për momentin e fundit.



Stefan Ingves  
Guvernator i Riksbank  
Shtator 2016

## Kërkoni në [myntkartan.se](http://myntkartan.se)

Keni sasi të mëdha monedhash?  
"Myntkartan" është një hartë që tregon se ku mund t'i depozitoni.

 [myntkartan.se](http://myntkartan.se)





# Kartëmonedhat e reja në tetor 2016

Në tetor 2016, Riskbank do të fillojë të nxjerrë në qarkullim kartëmonedha të reja prej 100 krona dhe 500 krona me motive të reja. Mund të kalojë pak kohë përpara se të shikoni një kartëmonedhë të re sepse kartëmonedhat aktuale prej 100 krona dhe 500 krona do të vazhdojnë të qarkullojnë njëkohësisht për një periudhë kohe.



## **Motivi i parëm (përpara)**

Aktorja Greta Garbo



## **Motivi i pasmë (mbrapa)**

Stokholm, ku u rrit  
Greta Garbo



## **Motivi i parëm (përpara)**

Këngëtarja  
operistike  
Birgit Nilsson



## **Motivi i pasmë (mbrapa)**

Skåne, ku u rrit  
Birgit Nilsson

# Monedhat e reja në tetor 2016

Në tetor 2016, Riskbank do të fillojë të nxjerrë në qarkullim monedhat e reja prej 1 krona, 2 krona dhe 5 krona. Monedha prej 10 krona do të mbetet e pandryshuar. Mund të kalojë pak kohë përpara se të shikoni një monedhë të re sepse monedhat aktuale do të vazhdojnë të qarkullojnë njëkohësisht për një periudhë kohe.

Monedhat e reja nuk përmbajnë nikel dhe janë më të lehta e të vogla se monedhat e tanishme.



1 krona e përparme  
(përpara)



1 krona e pasme  
(mbrapa)



2 krona e përparme  
(përpara)



2 krona e pasme  
(mbrapa)



5 krona e përparme  
(përpara)



5 krona e pasme  
(mbrapa)



Monedha prej  
10 krona do të mbetet  
e pandryshuar.

# Kartëmonedhat që bëhen të pavlefshme pas datës 30 qershor 2017

Kartëmonedhat aktuale prej 100 krona dhe 500 krona mund të përdoren si zakonisht deri më 30 qershor 2017.

## Data të rëndësishme

- 30 qershor 2017: dita e fundit kur kartëmonedhat mund të përdoren për të paguar.
- 30 qershor 2018: dita e fundit kur kartëmonedhat mund depozitohen në një llogari bankare.



## Mos i lini gjërat për momentin e fundit!

Bankat dhe dyqanet mund të kenë kufizime në lidhje me pranimin e kartëmonedhave. Kontaktoni bankën tuaj për informacion të mëtejshëm nëse keni sasi të mëdha kartëmonedhash për të depozituar.

Pas datës 30 qershor 2018, Riksbank mund t'i blejë kartëmonedhat e pavlershme për një pagesë administrative prej SEK 100.

## Përse duhet të bëjnë pyetje bankat

Kur doni të depozitoni paratë në bankë ose të bëni disa transaksione të tjera, duhet të jeni të gatshëm që t'i përgjigjeni pyetjeve se nga kanë ardhur paratë dhe duhet të tregoni një dokument identifikimi të vlefshëm. Në disa raste, bankës mund t'i duhet të shikojë edhe kontrata, fatura, ose dokumente të tjera që provojnë se si i keni marrë paratë. Kjo ka lidhje me Ligjin mbi Masat Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, që specifikon, ndërmjet të tjerash se bankat janë të detyruara të mësojnë se nga kanë ardhur depozitat.

Ky kontroll duhen bërë edhe kur nuk dyshohet për një krim. Qëllimi i ligjit është që të parandalojë bankat dhe kompanitë e tjera financiare që të përdoren për pastrim parash, që janë të ardhura nga aktivitete kriminale të cilat po konvertohen në para që mund të depozitohen në një llogari bankare dhe mund të përdoren. Këto rregulla zbatohen për të gjitha kompanitë financiare në Bashkimin Evropian.

Riksbank zbaton edhe Ligjin mbi Masat Kundër Pastrimit të Parave.

# Monedhat që bëhen të pavlefshme pas datës 30 qershor 2017

Monedhat aktuale prej 1 krona dhe 5 krona mund të përdoren si zakonisht deri më 30 qershor 2017.

E njëjta gjë zbatohet edhe për monedhat e vjetra prej 2 krona, nëse keni të tilla. Megjithatë, mund të jetë e vështirë të paguani me monedha 2 kronëshe, pasi ato përdoren rrallë për pagesa në ditët e sotme.

## Data të rëndësishme

- 30 qershor 2017: dita e fundit kur monedhat mund të përdoren për të paguar.
- 31 gusht 2017: dita e fundit kur monedhat mund deponohen në një llogari bankare.



1-krona



2-krona



5-krona

*Ju lutemi vini re se të gjitha monedhat e tanishme prej 1 krona, 2 krona dhe 5 krona do të bëhen të pavlefshme, jo vetëm monedhat e treguara më sipër.*

## Mos i lini gjërat për momentin e fundit!

Mund të jetë e vështirë për dyqanet dhe bankat të pranojnë sasi të mëdha monedhash, veçanërisht kur ne arrijmë në fazën përfundimtare të ndryshimit. Pyesni bankën tuaj ose dyqanin më të afërt për më shumë informacion.

**Pas datës 31 gusht 2017** nuk do të jetë më e mundur t'i shkëmbeni monedhat e pavlefshme në banka ose te Riksbank.

## Cilat monedha nuk po zëvendësohen?

Monedha prej 10 krona dhe monedhat përkujtimore të jubileve nuk do të bëhen të pavlefshme në vitin 2017. Të gjitha monedhat e tjera tashmë janë të pavlefshme dhe nuk mund të përdoren për të paguar ose për t'i shkëmbyer në banka ose në Riksbank.



# Anojeni kartëmonedhën - për t'u siguruar që është originale

Kartëmonedhat e reja kanë karakteristika të reja sigurie që i bëjnë të vështira të falsifikohen. Nëse e anoni kartëmonedhën, mund të kontrolloni që është origjinale.



## Shiriti i sigurisë

Shiriti vertikal me tre dritare. Dritaret shfaqin imazhe që lëvizin dhe alternojnë motivin ndërmjet "KR" dhe një kurore mbretërore kur e anoni kartëmonedhën. Pozicioni i shiritit mund të ndryshojë deri diku nga një kartëmonedhë tek tjetra.

## Imazhi të cilit i ndryshon ngjyra


Një imazh që i ndryshon ngjyra gradualisht nga flori në të gjelbër kur e anoni kartëmonedhën. Imazhi është i lidhur me personin e portretizuar në kartëmonedhë dhe tregon edhe vlerën monetare të kartëmonedhës.





# Data të rëndësishme

**Tetor 2015**



**Tetor 2016**



1-krona 2-krona 5-krona

**2015**

**2016**

**2017**

**Të pavlershme pas datës  
30 qershor 2016**



**Të pavlershme pas datës  
30 qershor 2017**



1-krona 2-krona 5-krona

Nëse ende i keni këto kartëmonedha,  
Riksbank mund t'i shkëmbejë ato kundrejt  
një pagese administrative prej SEK 100.

# Rreth Riksbank



Riksbank është banka qendrore e Suedisë. Ne nxjerrim në qarkullim kartëmonedhat dhe monedhat. Ne po ashtu siguroheni që paratë ta ruajnë vlerën e tyre dhe që pagesat të mund të bëhen me siguri dhe efikasitet.

## Informacion i mëtejshëm

- **Faqja e internetit:** riksbank.se/checkyourmoney
- **Aplikacioni:** Kërkoni për "Kolla pengarna" në dyqanin tuaj të aplikacioneve

## Informacion i mëtejshëm në suedisht

- **Facebook:** facebook.com/kollapengarna
- **Coinmap:** myntkartan.se
- **Kujtesa për datat e rëndësishme:**  
Dërgoni mesazhin **riksbanken start** në numrin 71120



## Ndryshimi i kartëmonedhave dhe monedhave vazhdon

Shqip العربية	Kurdîya kurmancî سۆرانی	Româña Русский
Surayt	Julevsámegiella	Srpski
Bosanski	Meänkieli	Soomaali
English	Davisámegiella	Español
Suomi	فارسی	Åarjelsaemien
Français	Polski	עברית/עברית
יידיש	Arlí	ไทย
中文	Kalderaś	Türkçe
Hrvatski	Kálo	Deutsch

[riksbank.se/languages](https://riksbank.se/languages)